



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.150/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Afijete Sada-Gllogjani dhe Ymer Hoxha anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e BIRN, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Alternativa, me seli në Gjakovë për shkak të bërjes së fushatës zgjedhore me fëmijë të mitur, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me datë 22.10. 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 12.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e organizatës BIRN, me seli në Prishtinë, ndërsa subjektit politik Alternativa, me seli në Gjakovë, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 3.000,00 (tremijë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Organizata BIRN me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 09.10.2017, me të cilën pretendon se kandidatja për kryetar të Komunës së Gjakovës nga subjektit politik Alternativa, ka shkelur Rregullën zgjedhore 13/2013 konkretisht nenin 5.2 duke i përfshirë persona të mitur në një video promovuese gjatë fushatës e cila është publikuar në faqen e saj publike të facebookut me datën 08.10.2017, ku nga përmbajtja e video incizimit shihet se ka thirrje për votim të subjektit të saj politik.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur një CD, nga vendi ku ka ndodhur shkelja, si dhe fotot e marra nga faqja publike e kandidates në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik Alternativa, të datës 10.10.2017, theksoi se kandidatja e tyre për kryetar të komunës së Gjakovës Mimoza Kusari- Lila ka vajtur për vizitë tek përfaqësuesit e kësaj shoqate me ç ‘rast në shoqatë kanë qenë prezent prindërit pra përfaqësuesit e ligjor te fëmijëve te anëtarësuar ne këtë shoqatë dhe personat e te ndryshëm të prekur me down syndrome, ku me kërkesën dhe me pëlqimin e tyre ka realizuar vizitën në fjalë. Si dëshmi ka bashkangjitur pëlqimin e dhënë nga ana e prindërve. I njëjti kërkon nga PZAP-i që ankesa e bërë ndaj tyre nga BIRN të hudhet poshtë.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli nga CD e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se Mimoza Kusari -Lila, kandidate për Kryetare të Komunës së Gjakovës nga radhët e subjektit politik Alternativa, ka përdorur në spotin e saj fëmijë të moshës nën 18 vjet, si dhe ka publikuar edhe në rrjetin e saj social të Facebookut, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 5.2 të Rregullës Zgjedhore nr. 13/2013 të KQZ-së e cila përcakton: “Në fushatën e zgjedhjeve të asnjë subjekti politik të certifikuar nuk mund të përfshihen personat që nuk i kanë mbushur 18 vjet”.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysht rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysht të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysht faktin se subjekti politik Alternativa, nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se të njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Si rrethanë, Paneli e mori edhe faktin që këtij subjekti politik, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre të njëjtit në arsyetimin e tyre theksojnë se vizita e realizuar është bërë me pëlqimin e prindërve, e ku pretendimet e tilla nga ana e Panelit janë të vlerësuar si të paqëndrueshme pasi që dispozita ligjore e nenit 5.2 të Rregullës Zgjedhore nr. 13/2013 të KQZ-së përcakton qartë se personat të cilat nuk i kanë mbushur moshën 18 vjet nuk mund të përfshihen në fushatën zgjedhore të asnjë subjekti politik të certifikuar për zgjedhje, ndërsa nga video incizimi në CD shihet se vizita e realizuar ka karakter të fushatës zgjedhore të subjektit politik në fjalë pasi që në fund të video incizimit shfaqet edhe llogoja e subjektit politik Alternativa.

Paneli si rrethanë mori parasysht faktin se vizita e realizuar nga kandidatja Mimoza Kusari-Lila është realizuar në zyrat e kësaj shoqate ku dispozita ligjore e nenit 35.1 e LZP-së përcakton se *personi që mban pozitë publike, i zgjedhur apo i caktuar, nuk mund të përdorë atë zyrë ose ndonjë nga pasuritë e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike, ose edhe ndonjë ndërmarrje në zotërim ose të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale nuk mund të shfrytëzohen ose të futen në mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje.* Andaj me këtë rast kandidatja në fjalë ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e lartcekura ligjor duke bërë fushatë zgjedhore në objekte publike i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi, me të cilën paneli vlerësoi se gjoba e shqiptuar do të ndikon që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Zl.Anr. 150/2017 më datën 12.10.2017.



Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.